



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 26 qershor 2012
Nr.Rcf.:RK259/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Në

Rastin Nr. KI152/11

Parashtruesi

Bekim Murati

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës
(11/279), të 07.11.2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe
Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i Kërkesës është Bekim Murati nga Prishtina, i përfaqësuar nga Bajram Morina, avokat nga Gjakova.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Qeverisë së Kosovës 11/279, të datës 06/11/2007 (në tekstin e mëtejme: Vendimi).

Baza juridike

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) , nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 30 e 75 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovë (në tekstin e mëtejme:Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 24 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
5. Më 17 janar 2012, Kryetari emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.
6. Më 24 janar 2012, Gjykata ia komunikoi kërkesën Zyrës së Kryeministrit (në tekstin e mëtejme: ZKM).
7. Më 27 shkurt 2012, Gjykata i dërgoi letër ZKM duke kërkuar informata shtesë, më saktësisht nëse Vendimi ishte ende në fuqi.
8. Më 27 shkurt 2012, Gjykata i dërgoi letër parashtruesit të kërkesës duke kërkuar informata shtesë, më saktë nëse parashtruesi i kërkesës ka marrë hapat e mëtejshëm në institucionet përgjegjëse për të kontestuar Vendimin.
9. Më 9 mars 2012, ZKM u përgjigj se “vendimi në fjalë ishte marrë duke pasur parasysh rrethanat dhe kushtet në atë kohë dhe i njëjti vendim është ende në fuqi”. Përveç kësaj, ZKM informoi se “deri më tani nuk ka pranuar ndonjë ankesë lidhur me vendimin apo kërkesë për të shfuqizuar Vendimin e lartpërmendur nga palët e interesuara dhe nga Komisioni i Konkurrencës si autoritet kompetent për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare Nr. 88, 25 nëntor 2010)”.
10. Më 19 mars 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës paraqiti informatat e kërkuara shtesë, duke sqaruar se parashtruesi i kërkesës ka kontaktuar autoritetet publike në mënyrë që të ngrejë brengat e veta lidhur me Vendimin, por ai ka marrë vetëm këshilla verbale që t'i drejtojnë këtë çështje Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 20 qershor 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmeri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës është pronar i agjencisë turistike “Royal Travel”, e cila operon në Prishtinë dhe, më 14 janar 2011, Departamenti i Turizmit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (në tekstin e mëtejme: MTI) i dha agjencisë turistike “Royal Travel” “lejen për ushtrimin e veprimtarive turistike për një periudhë tri vjeçare si: **Agjenci Turistike-Organizatore**”.
13. Sidoqoftë, më 7 nëntor 2007, Qeveria e Kosovës mori Vendim, përmes të cilit përcaktohet se “Bashkësia Islame e Kosovës është i vetmi institucion legjitim për të organizuar shkuarjen në haxhillëk për qytetarët e Kosovës”.
14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Qeverisë së Kosovës shkel nenin 119.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), ku përcaktohet se “Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të

ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj”. Parashtruesi i kërkesës pohon se atij i ishte shkelur “e drejta themelore për punë, e garantuar me nenin 49.1 të Kushtetutës së Kosovës”.

15. Me pak fjalë, parashtruesi i kërkesës ankohet se Vendimi shkel nenin 10 [Ekonomia] dhe nenin 119.3 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës, pasi që ai krijon pozitë dominuese për Bashkësinë Islame si të vetmin institucion legjitim për organizimin e Haxhillëkut për qytetarët e Kosovës.
16. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) “të anulojë Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 11/279, të datës 7 nëntor 2007”.

Vlerësim paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

17. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka justifikuar kërkesën me fakte relevante dhe referim të qartë të shkeljeve të pretenduara; shprehimisht konteston Vendimin si akt konkret i autoriteteve dhe objekt shqyrtimi; qartë tregon ndihmën e kërkuar, qartazi thekson ndihmën që kërkon; dhe bashkangjet vendime të ndryshme si dhe informata e dokumente mbështetëse.
18. Sidoqoftë, me rastin e vlerësimit të kushtit të afateve, Gjykata vëren se neni 56 (Rastet paraprake) i Ligjit parasheh:

“Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.
19. Në anën tjetër, në nenin 49 (Afatet) të Ligjit thuhet:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.
20. Duke pasur parasysh këto dy dispozita ligjore, mund të konkludohet se juridiksioni kohor i Gjykatës Kushtetuese për rastet e mëhershme fillon nga dita e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, që ishte më 15 qershor 2008, dhe përfundon më 15 maj 2009, domethënë katër muaj (shih nenin 49 të Ligjit) pas hyrjes në fuqi të Ligjit, që ishte më 15 janar 2009.
21. Gjykata vëren se, në këtë rast, Vendimi ishte marrë më 7 nëntor 2007, domethënë, para hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15 qershor 2008. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij më 24 nëntor 2011.
22. Për më tepër, Gjykata vëren se agjencisë turistike “Royal Travel” i ishte dhënë “leja për ushtrimin e veprimtarive turistike (...) si: Agjenci Turistike-Organizatore” më 14 janar 2011. Vendimi ishte në fuqi që nga 7 nëntori 2007.
23. Rrjedhimisht, Vendimi ishte marrë para 15 qershorit 2008, data kur hyri në fuqi Kushtetuta. Gjykata nuk mund të merret me kërkesën që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih, Aktvendimi i Gjykatës për papranueshmërinë në rastin Nr. 18/10, Denic et al të datës 17 gusht 2011).

24. Gjykata po ashtu rikujton se ZKM ka informuar se “deri më tani nuk kanë pranuar asnjë ankesë lidhur me atë vendim ose kërkesës për të shfuqizuar Vendimin e lartpërmendur nga palët e interesuara”.
25. Për më tepër, rregulli 36 (3) h) i Rregullores parasheh se “Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese” kur “kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën”. Kështu që, Gjykata konsideron se kërkesa është paafatshme “*ratione temporis*”.
26. Kështuqë, Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme dhe kështu “*ratione temporis*” në mospajtim me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2012, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani